



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

UDHËZIM

**“PËR MËNYRËN E PASQYRIMIT TË KONSUMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË
FATURËN MUJORE, IDENTIFIKIMIN E NDARË TË KATEGORIVE TË
KONSUMATORËVE DHE ZBATIMIN E CMIMEVE PËRKATËSE”**

Neni 1

Qëllimi

Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e mënyrës së detajuar të pasqyrimin të konsumit të energjisë elektrike në faturat mujore të furnizimit, me qëllim sigurimin e transparencës, ndarjen e qartë të konsumit sipas kategorive të konsumatorëve dhe garantimin e aplikimit të drejtë të tarifave dhe cmimeve përkatëse për çdo kategori konsumatori.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim zbatohet nga furnizuesi publik i energjisë elektrike, Furnizuesit e tregut të lirë për kategoritë përkatëse të konsumatorëve ndaj të cilëve ofrojnë shërbim dhe operatorin e sistemit të shpërndarjes (OSSH), si dhe për të gjithë konsumatorët fundorë që kanë lidhur kontrata furnizimi për kategori të ndryshme konsumatore të përcaktuara nga ERE.
2. Dispozitat e këtij udhëzimi janë të detyrueshme për subjektet që realizojnë faturimin, matjen dhe raportimin e konsumit të energjisë elektrike ndaj konsumatorëve.

Neni 3

Ndarja e konsumit në faturë sipas kategorive tarifore

1. Konsum familjar/jofamiljar:

- a) Konsumi për nevoja familjare duhet të pasqyrohet në faturë në mënyrë të qartë dhe të veçantë, me aplikimin e cmimit të miratur nga ERE.
- b) Rubrika përkatëse në faturë duhet të mbajë titullin “Konsum familjar” dhe të shoqërohet me matësin përkatës.

2. Konsum për karikimin e automjeteve elektrike (EV):

- a) Në rastet kur konsumatori ka të instaluar një pikë/stacion karikimi të makinave elektrike me fuqi të instaluar mbi 11 kW dhe është i lidhur në nivelin e tensionit 04 kV, energjia e përdorur për karikimin e automjetit elektrik duhet të matet përmes një njësie matëse të pavarur.

Miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 294, datë 13.11.2025

b) Konsumi për karikimin e automjetit elektrik duhet të pasqyrohet në faturë të veçantë me titullin “Konsum për karikim automjeti elektrik (EV)”, me aplikimin e cmimit përkatës të miratuar nga ERE.

c) Furnizuesi duhet të specifikojë në faturëfuqinë përkatëse të instaluar në kW per kategorinë e konsumatori mbi 11 kW.

3. Konsumatorë vetëprodhues:

a) Për konsumatorët që prodhojnë energji elektrike nga burime të rinovueshme (pale fotovoltaike, etj.), fatura mujore duhet të përmbajë dy rubrika të ndara:

- “Energjia e prodhuar nga vetë konsumatori (kWh)”;
- “Energjia e marrë nga rrjeti (kWh)”.

b) Faturimi neto ndërmjet energjisë së prodhuar dhe asaj të marrë nga rrjeti llogaritet dhe reflektohet ne fature sipas metodologjisë së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

c) Furnizuesi është i detyruar të garantojë pasqyrimin e qartë dhe të lexueshëm të të dhënave të vetëprodhimit në faturën mujore.

Neni 4

Identifikimi i kategorisë së konsumatorit në faturë

1. Çdo faturë mujore duhet të përmbajë seksionin “Kategoria e konsumatorit sipas kontratës”, ku të shënohet qartë kategoria përkatëse.
2. Kategoritë që duhet të identifikohen në faturë janë:
 - Familjar
 - Te tjere te lidhur ne 0.4 të furnizuar nga Furnizuesi Universal
 - Familjar me konsum nën 700 kW
 - Konsumator i FMF
 - Objekt kulti
 - Furra buke / Prodhim mielli (sipas nen-kategorive)
 - Pika / Stacione karikimi automjetesh elektrike (EV)
 - Vetëprodhues (me burime të rinovueshme të energjisë)
 - Ujësjiellës kanalizime të lidhura në nivelin e tensionit 35 KV/20/10/6 KV
 - Të tjera, sipas përcaktimeve ligjore ne fuqi.
3. Mosidentifikimi i kategorisë përbën shkelje të detyrimeve të faturimit dhe i nënshtrohet masave administrative sipas vendimeve të ERE.

Neni 5

Detyrimet e furnizuesve dhe operatorëve të rrjetit

1. Furnizuesit e energjisë elektrike janë të detyruar të:
 - përditësojnë sistemet e faturimit elektronik për të mundësuar pasqyrimin dhe faturimin e konsumit sipas kategorive te konsumatoreve;

Miratur me Vendimin e Bordit të ERE nr. 294, datë 13.11.2025

- raportojnë çdo tre muaj pranë ERE listen e kontratave të konsumatorëve që disponojnë pajisje karikimi për automjete elektrike dhe/ose kapacitete vetëprodhimi.
2. Operatori i sistemit të shpërndarjes (OSSH) ose Operatori i Transmetimit ka detyrimin të:
- verifikojë instalimet matëse për konsumet e ndara;
 - sigurojnë që matjet të jenë të sakta, të certifikuara dhe të azhurnuara sipas standardeve metrologjike në fuqi.
 - raportojnë çdo tre muaj pranë ERE mbi sasinë e energjisë së shpërndarë për çdo kategori të përcaktuar në nenin 4 pika 2, fuqinë e instaluar/ngarkesë për çdo pike, si dhe shpërndarjen gjeografike të çdo pike.

Neni 6

Zbatimi dhe kontrolli

1. Zbatimi i këtij udhëzimi është detyrë e furnizuesve dhe operatorëve të sistemit të shpërndarjes.
2. Kontrolli i zbatimit kryhet nga ERE dhe njoftohet rregullisht Agjencia për Eficiencën e Energjisë (AEE) për gjetjet.
3. Në rastet e shkeljeve të përcaktuara në këtë udhëzim, ERE do të marrë masa administrative në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 7

Të tjera

1. Për konsumatorët ekzistues të cilët kanë një pikë/stacion karikimi me fuqi të instaluar mbi 11 kW të lidhur në nivelin e tensionit 0,4 kV, të cilët kanë një pikë lidhje të miratur, por nuk kanë një kontratë furnizimi, Furnizuesi i Sherbimit Universal duhet të gjenerojë një kontratë të re furnizimi. Konsumatorët ekzistues nuk ngarkohen me kosto shtesë për instalimin e një sistemi matje për këto pika/stacione karikimi.
2. Të gjithë konsumatorët që aplikojnë për herë të parë për një pikë/stacion karikimi me fuqi të instaluar mbi 11 kW të lidhur në nivelin e tensionit 0,4 kV, duhet të lidhin kontratë të re me furnizuesin i cili ofron këtë shërbim.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i Komisionerëve të ERE.